



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

RREGULLORE
PËR PËRFSHIRJE GJINORE
NË SHOQATËN E TË
VERBËRVE TË KOSOVËS

Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës në Republikën e Kosovës, Statutin e SHVK-së dhe ka përfshirë praktikatat më të mira për ndërtimin e normave të barazisë gjinore në organizatë.

Duke u bazuar në Statutin e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, Këshilli Drejtues i SHVK-se
së me vendim miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PËRFSHIRJE GJINORE

NENI 1

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të sigurojë integrimin dhe përfshirjen e barabartë gjinore në të gjitha strukturat e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, si dhe të promovojë politika të përfshirjes së barabartë gjinore në të gjithë veprimtarinë e kësaj organizate.

NENI 2

FUSHËVEPRIMI

Kjo rregullore aplikohet në të gjitha strukturat e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, përfshirë Kuvendin, Këshillin Drejtues dhe Stafin e rregullt.

NENI 3

PËRKUFIZIMET¹

Barazia gjinore - është ushtrimi i plotë dhe i barabartë i femrave dhe meshkujve i të drejtave të tyre të njeriut. Është mospranim e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitë, ndarjen e burimeve apo përfitimeve si dhe qasjen në shërbime

Pjesëmarrja e barabartë gjinore: Pjesëmarrje e barabartë e vajzave/ grave dhe djemve/burrave në të gjitha fushat e jetës, pozitë e barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si edhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e atij zhvillimi.

Trajtim i Barabartë Gjinor: Mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë gjinor: trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me ndonjë individ tjetër të gjinisë së kundërt në rrethanave të njëjta apo të ngjashme.

¹ Përkufizimet janë bazuar në përkufizimet e Ligjit për Barazi Gjinore Nr. 05/L -020 të aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Diskriminimi i tërthortë gjinor - konsiderohet kur, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin e gjinisë tjetër në pozitë të pabarabartë, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme;

Parimi i trajtimit të barabartë: nënkupton se nuk duhet të zbatohet asnjë formë e diskriminimit apo trajtimit të pabarabartë ndaj një personi, duke u bazuar në gjininë, moshën, gjendjen martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes apo statuseve të tjera.

Femër - përfshin çdo person që konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor;

Mashkull - përfshin çdo person që konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor

Seksi - nënkupton karakteristikat biologjike dhe fiziologjike të cilat përcaktojnë meshkujt dhe femrat;

Gjinia - nënkupton role të krijuara shoqërore të cilat i atribuohen femrave dhe meshkujve, që është identiteti i fituar që mësohet, pëson ndryshime me kalimin e kohës dhe ndryshon përgjithësisht brenda dhe ndërmjet kulturave.

NENI 4

STANDARTET

Pjesëmarrja e barabartë gjinore vendoset përmes politikave të përcaktuara të organizatës përfshirë Statutin, Rregulloren e Kuvendit të Anëtarëve, të Këshillit Drejtues, të Burimeve Njerëzore apo çdo dokument tjetër rregullativ.

Pjesëmarrja e barabartë gjinore arrihet atëherë kur pjesëmarrja e një gjinie është 50 % në të gjitha nivelet e organizatës.

Të gjitha dokumentet rregullative në kuadër të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës duhet të reflektojnë në harmoni pjesëmarrjen e barabartë të të dy gjinive.

NENI 5

KUVENDI I ANËTARËVE

Kuvendi i anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës. Kuvendi i anëtarëve përbehet nga delegatët e përzgjedhur nga shoqatat komunale dhe ndërkomunale të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.

Në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit të Anëtarëve të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, përfaqësimi i grave në nivel lokal për sa i përket delegatëve duhet të jetë minimalisht 30%.

NENI 6

KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues i SHVK-së përbëhet nga 7 anëtarë me të drejtë vote dhe ata janë: Kryetari i Organizatës, Nënkyetari i parë, Nënkyetari i dytë dhe 4 Anëtarë.

Në linjë me Rregulloren për punën e Këshillit Drejtues të SHVK-së, përfaqësimi gjinor në 6 anëtarët e Këshillit Drejtues të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës (duke përjashtuar kryetarin/ën), duhet të jetë 50% gra dhe 50% burra.

NENI 7

STAFI I ORGANIZARËS

Procedurat e rekrutimit në organizatë duhet të zbatohen duke respektuar parimet se çdo diskriminim në baza gjinore është i pa tolerueshëm.

Stafi i organizatës duhet të reflektojë barazinë gjinore

NENI 8

AKTIVITETET E ORGANIZATËS

Shoqata e të Verbërve të Kosovës siguron qasje të barabartë për të dy gjinitë në të gjitha aktivitetet e organizatës.

Shoqata e të Verbërve të Kosovës promovon dhe zbaton parimet e trajtimit të barabartë gjinore në të gjitha aktivitetet e organizatës.

Duke qenë aktualisht më e vogël në numër, pjesëmarrja e vajzave dhe grave inkurajohet veçanërisht, në të gjitha aktivitetet që ndërmerr organizata.

NENI 9

VENDIMMARRJA

Vendimet që merren nga organet kompetente të organizatës, mundësisht dhe kur aplikohet, shqyrtohen edhe në aspektin e përfshirjes gjinore.

NENI 10
ZBATIMI

Të gjitha strukturat e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës janë të obliguar të marrin parasysh dhe të respektojnë të gjitha kërkesat që dalin nga kjo rregullore.

NENI 11
HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj me Vendim të Kuvendit të Anëtarëve.

Aprovuar nga Kuvendi i Anëtarëve të SHVK-se

Prishtinë, 2022

Daüt Tishuki

